


ATY KU NE RRITEMI



PËR ÇDO DITË

DEMOKRACIA, SISTEM I SHKËLQYER

ARDIT (12), METIJE (11), RAMUSH (11), ZAHIR (11), ELIONA (12)



Këtij artikulli ia kemi lënë emrin: „Demokracia, sistem i shkëlqyer“. Por, përse ia kemi lënë pikërisht këtë emër? Këtë do ta mësoni më poshtë

Ne jemi nxënës të shkollës „Halil Alidema“. Këtu në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ filluam të mësonim për demokracinë. Demokracia është sistem i qeverisjes, i cili u shpik në Greqi. Më saktësisht në shtet-qytetin e quajtur Athinë. Kjo ndodhi në vitin 507 para erës sonë, përafërsisht 2500 vjet më parë. Kjo formë e demokracisë quhet demokracia direkte. Këtu, qytetarët e shumtë të Athinës, mbledheshin dhe bisedonin së bashku. Në fund, ata merrnin një vendim të përbashkët. Mirëpo, Athina, me kalimin e kohës u mbush me më shumë banorë. Kështu, lindi forma tjetër e demokracisë. Kjo quhet demokracia përfaqësuese. Ju mund të pyesni veten, cilën formë të demokracisë e kemi ne në Kosovë? Ne kemi demokracinë përfaqësuese.

Edhe para se të vijmë në Punëtoritë e Demokracisë, ne kemi dëgjuar për të drejtat e njeriut. Disa nga të drejtat e njeriut janë: e drejta e shkollimit, e drejta për të pasur shokë dhe shoqe, e drejta për familje, e drejta për të pasur një ambient të pastër, e drejta për të pasur një strehim të sigurtë, e drejta për të luajtur dhe për t'u argëtuar, etj. Ne dëshirojmë të flasim më shumë për të drejtën për të pasur shokë e shoqe, apo të drejtën për t'u shoqëruar me të tjerët. Në klasën tonë, para 2 vjetëve, erdhi një nxënës i ri nga qyteti i Prizrenit. Ai quhej Flamur. Flamuri në fillim ndihej shumë i vetmuar, sepse nuk njihnte asnjë shok/shoqe të klasës. Në ditët e para ai qante, sepse frikësohej. Në shkollën e tij të vjetër, nuk e kishin trajtuar edhe aq mirë. Prandaj, edhe frikësohej të vinte në klasën tonë. Në një nga orët e para mësimore të Flamurit, ne vendosëm që të shkojmë të flasim dhe të njihemi me të. Ai vazhonte akoma të frikësohej, por ne nuk u dorëzuam. Të nesërmen vazhduam prapë t'i flisnim. Ai na tregoi se kishte një ëmbëltores. Familja e Flamurit kishte ardhur nga Prizreni në fshatin tonë për ta hapur atë. Aty afër ëmbëltores, së bashku filluam të luanim futboll. Ai kishte një talent të jashtëzakonshëm për futboll. Ditën tjetër, ai nuk frikësohej më, sepse ne e mbështetëm dhe ishim afër tij. Ai tash më nuk langohej nga ne dhe nuk qante kur vinte në klasë. Neve na erdhi shumë mirë për shokun tonë më të ri, sepse siç edhe e dijme, gjithëpërfshirja dhe trajtimi në mënyrë të barabartë janë vlera demokratike.



Shokët të cilët bashkëpunuan sot për këtë artikull

KUVENDI, INSTITUCION UDHËHEQËS

LUMBARDH (12), ALKETA (12), ALBIN (12), DRILONA (11), TRINGA (11)



Ne jemi gazetarët, të cilët do të flasim për Kuvendin si institucion udhëheqës. Por, kush e zgjedh Kuvendin dhe si punon ai, do ta zbuloni në vijim

Përshëndetje, të dashur lexues. Ne do të flasim për Kuvendin, institucionin më të dashur për ne. Kuvendi është vendi ku miratohen ligjet. Ai përbëhet prej 120 deputetëve. Prej tyre 100 janë shqiptarë dhe 20 janë prej etnive të ndryshme që jetojnë në Kosovë. Por, cilat janë ato? Këto etnitete quhen komunitete jo shumicë. Në Kosovë kemi: komunitetin serb, atë turk, ko-



munitetin boshnjak, egjiptian, atë romë, goran, si dhe atë ashkali. Deputetët zgjedhen nga populli. Të drejtë vote kanë vetëm ata qytetarë, të cilët janë mbi 18 vjet. Deputetët zgjedhin Kryetarin e Kuvendit. Mandati i deputetëve dhe i Kryetarit të Kuvendit zgjat 4 vjet. Kjo do të thotë që ne dalim çdo 4 vjet në zgjedhje. Kuvendi përfaqëson popullin, për këtë arsye ai ka funksion përfaqësues. Po ashtu, Kuvendi është institucion ligjvënës, sepse miraton ligjet dhe këtë detyrë e ka

vetëm ky institucion në Kosovë. Kuvendi ka edhe një detyrë tjetër. Ajo është kontrollimi i punës që e bën Qeveria. Këtë e bënë duke i bërë pyetje ministrave. Në këtë pjesë të artikullit, dëshirojmë të shkruajmë për ligjet. Ligjet janë rregulla që duhet të zbatohen nga të gjithë ne. Disa prej tyre janë: ligji i komunikacionit, ai i shkollimit, ai për pirjen e duhanit, ai i mbeturinave, etj. Për më shumë, ne do të flasim për ligjin e mbeturinave. Ne si nxënës duhet të respektojmë ligjin e mbeturinave në mënyrë që t'i hedhim mbeturinat në vende të caktuar e jo t'i lëmë ato vend e pa vend. Një ditë prej ditësh, ne pamë disa fëmijë të cilët po hedhnin mbeturina në rrugë. Ne ndaluan dhe filluam t'i u tregonim që ata duhet të kenë kujdes, t'i hedhin mbeturinat në vende të caktuar e ta mbrojnë mjedisin që të gjithë të kemi një ambient të pastër. Biseda jonë përfundoi, kur ata u bindën se nuk kishin vepruar edhe aq mirë. Falenderojmë Kuvendin që na ka sjellur ligje të reja të mirë. Me respektimin e ligjeve dashuria dhe harmonia mes njëri-tjetrit rritet. Kështu rritet edhe demokracia!



Autorët e kësaj pune të mrekullueshme

RËNDËSIA E EDUKIMIT QYTETAR

LEART (12), VANESA (13), BESJANA (11), ELSA (12), FISNIK (11), EGZON (12), DENISA (11), FLOAR (12),

MENDIM (11)

Ne, nxënësit e klasës së VI dhe VII, sot kemi mësuar shumë gjëra të reja për qytetarinë aktive. Por, përveç kësaj kemi mësuar edhe arsye se pse është e rëndësishme që qytetarët të jenë aktiv në vendin e tyre. Vazhdoni leximin

Çka është edukimi qytetar dhe cila është rëndësia e tij? Me këtë pyetje të parashtruar nga edukatorja jonë, ne filluam diskutimin për qytetarinë aktive. Edukimi qytetar është përgatitja e individëve për të marrë pjesë si qytetarë aktiv në demokraci. Qytetaria aktive në një mënyrë apo në tjetrën, iu referohet marrëdhënieve në mes qytetarëve, si dhe marrëdhënieve në mes qytetarëve dhe personave të cilët udhëheqin vendin. Janë qytetarët aktiv, ata të cilët i zgjedhin përfaqësuesit, por edhe kërkojnë llogari prej tyre. Pra, qytetarët aktiv, nuk janë aktiv vetëm në një periudhë të vitit, por ata janë aktiv gjatë gjithë jetës së tyre.



Aktiv mund të jemi në forma të ndryshme. E se si nxënësit e moshës tonë mund të jenë aktiv, shikoni vizatimet e shokëve dhe shoqeve të mia

Edukimi qytetar nuk do të thotë vetëm të mësojmë se si të jemi qytetarë të mirë tani, por edhe si të praktikojmë qytetarinë tonë dhe të jemi qytetarë më të mirë edhe në të ardhmen.

Pse edukimi qytetar? Qytetaria jonë pasqyron se kush jemi ne dhe si jetojmë me njëri-tjetrin. Qëllimi i këtij edukimi është vetëdijësimi i qytetarëve për çështje që prekin direkt jetën e tyre. Më lart e kemi cekur që qytetarët zgjedhin vetë përfaqësuesit e tyre. Ne të gjithë e dimë që kjo është e drejtë e çdo qytetari, por po ashtu e dimë që jo çdo qytetar merr pjesë në procesin zgjedhor. Për këtë është i nevojshëm edukimi qytetar, që secili individ të dijë që roli i tij në komunitetin ku ai/ajo jeton është shumë i madh. Por, edhe të dijë se angazhimi i tij për një komunitet sa më të mirë është shumë i nevojshëm. Ashtu siç edhe ju e dini, në demokraci

të gjithë qytetarët janë të barabartë. Ani pse ndryshojnë nga njëri-tjetri sipas kulturës, besimit, gjinisë, etj., ata prapëseprapë trajtohen të tillë, të barabartë. Në vendin ku ne jetojmë, në Pozheran, është vetëm një familje që i përket fesë tjetër, por angazhimi i tyre për fshatin është i njëjtë si i shumicës. Të gjithë qytetarët e komunitetit tonë, punojnë që ne fëmijët të kemi një jetë sa më të mirë aty. Përfshirë këtu edhe mësuesit tanë, të cilët na edukojnë në këtë aspekt.

Ne nxënësit e klasëve të VII-të, të premtën e fundit të muajit mblidhemi dhe pastrojmë të gjitha klasat e shkollës sonë. Ndërsa, nxënësit e klasëve të VIII-të mblidhen të hënën e parë të muajit. Ky është një proces që ne e bëjmë me shumë kënaqësi, sepse shkolla është shtëpia jonë e dytë. Aty marrim dije dhe trajtohemi në mënyrë të barabartë.




Shoku ynë Mendimi, ka paraqitur qytetarët e fshatit tonë



Floari ka paraqitur gjelbërim dhe qytetarët aktiv të fshatit

NE ZGJODHËM TË KEMI NJË SHTET DEMOKRATIK

ERËZA (11), RITA (12), ERIJON (11), ZYMRIJE (11), ATDHE (11), AURITA (13), FJORDAN (12), URAN (13),
ARTBESA (12)



Sot mësuam se sa të rëndësishme janë zgjedhjet dhe çfarë përgjegjësie kemi ne si qytetarë. Për tu informuar më shumë lexojeni artikullin

Ne jetojmë në një shtet të pavarur dhe demokratik. Kjo ndikon shumë tek ne si qytetarë, sepse ne kemi shumë të drejta. Sot, ne kemi zgjedhur të flasim për njërën nga të drejtat tona. Ajo është e drejta për të zgjedhur. Ne mund të zgjedhim profesionin sipas dëshirës sonë, varësisht se ku ne e gjejmë veten. Ne mund të zgjedhim të merremi me ndonjë aktivitet, ku si shembull kemi marrë rastin e shoqes sonë, Artbesës. Artbesa me shumë vullnet dhe dashuri, ka zgjedhur të prodhojë kartolina të ndryshme dhe t'i dizajnojë ato sipas dëshirës së saj. Por, kjo zgjedhje, ndikon vetëm tek Artbesa dhe tek të afërmit e saj. Ne kemi edhe shumë zgjedhje të tjera, të cilat ndikojnë jo vetëm tek ne, por edhe tek qytetarët e tjerë.

Një mike tjetër e jona e quajtur Aurita, dëshiron të studiojë degën e Farmacisë. Nëse ajo arrin atë që dëshiron, pra t'i përfundojë studimet, mund të na ndihmojë të gjithë qytetarëve. Edhe pse, ndoshta zgjedhja që ka bërë Aurita, nuk mund të ndikojë tek të gjithë qytetarët, sepse një profesion të tillë mund ta kenë edhe persona të tjerë, prapëseprapë është profesion shumë i nevojshëm për qytetarët e çdo vendi.

Në shtetin tonë, kemi zgjedhje të cilat mund të përfshijnë një komunë të tërë, por edhe zgjedhje të cilat e përfshijnë të gjithë shtetin tonë. Zgjedhjet lokale

(komunale), janë ato lloj zgjedhjesh ku qytetarët e një komune, dalin dhe votojnë duke zgjedhur kështu Kryetarin e komunës së tyre dhe asamblistët e asaj komune. Ndërsa, zgjedhjet qendrore janë zgjedhjet ku përfshihen të gjithë qytetarët e Kosovës, duke votuar për kandidatët e tyre të preferuar për deputetë.

Këto zgjedhje, qytetarët i bëjnë me t'i mbushur 18 vjet. Kjo sepse në atë moshë arrihet pjekuri e mjaftueshme për ta bërë një zgjedhje kaq të rëndësishme. Themi se këto zgjedhje janë të rëndësishme, sepse personat e zgjedhur, do të jenë në pozitën e përfaqësuesve për 4 vjet me radhë.

Pra, me gjithë këtë çka ne kemi shkruar në këtë artikull, ne dëshirojmë të themi se votat tona ndikojnë më së shumti tek shteti ynë, prandaj duhet të kemi kujdes se kë e zgjedhim.



Fryma e re e gazetarëve demokratikë ndihet ngado që shkojmë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: VI-4 & VII-1
Vendi: Pozheran, Viti